

SHQIPJA, RUAJTJA E IDENTITETIT DHE PASURIMI I SAJ NË EPOKËN E GLOBALIZIMIT

Astrit MEMIA¹

¹Faculty of Philology, University of Tirana, Albania

Përmbledhje

Tre Gj-të: Gjaku, Gjuha, Gjeografia përbëjnë ADN-në e etnogjenezës së hapësirës jetike shqiptare si komb providencialo-hyjnor. Gjuha shqipe e rimirëformatuar standarde do të marrë vendin meritore si instituti i gjithë diturisë dhe do t'i shërbejë qytetërimit të brezave, arsimit, shkencës, kulturës, pasurimit, ekonomisë së tregut. Gjuha shqipe natyrore dhe bashkëkohore e mirëpërdorur, mbështetur në rrafshin diakronik e sinkronik, do të ngrejë jetën duke i dhënë kuptim të plotë, vlerë dhe dinjitet njerëzor. Psikika etnokulturore⁷shqiptare dhe veshja e mendimit përmes gjuhës është çelësi i lirisë dhe i demokracisë së qytetërimit tonë mbarëkombëtar.

Kërkohet guxim, vendosmëri, përgjegjësi nga elita intelektuale për të sotmen e të nesërmen e dijes, shkencës, gjuhës, albanologjisë, etnokulturës. Përmirësimi dhe pasurimi i standardit edhe me forma e shprehje të mbetura jashtë sistemit sot është domosdoshmëri. Shqiptarët autoktonë në trojet e veta etnike të Ballkanit Ilirik, në Shqipëri e Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Çamëri e Preshevë, kanë derivuar realitete krejtësisht të reja sociolinguistike, si dhe pozitivitetin e krijimit të sociolekteve të një “përzierjeje të folmesh” drejt zgjerimit të gjuhës standarde e çlirimit nga “gjuha e drurit” për t'u larmue me prurje nga dialekti gegë dhe arbëresh. Që në lashtësi, nga mendimtarët, përdorimi i gjuhës amtare është formuluar si rregullator i jetës politike.

Përderisa përvetësimi i standardit nuk ka arritur në nivelet e duhura, diskutimi mbi çështjen e planifikimit dhe politikave gjuhësore, mbi standardizimin e 1972-shit nuk është më temë tabu. Gjuha shqipe si kryevlerë e kohës do të jetë një urë afrimi me Perëndimin dhe do t'i shërbejë progresit e prosperitetit. Çështja e rivitalizimit, e ruajtjes dhe domosdoshmëria e pasurimit të gjuhës shqipe duhet të kuptohet nga politikanët, qeveritarët dhe intelektualët shqiptarë si nevojë e kohës dhe oksigjen për brezat e rinj. Pasurimi i standardizimit do të ndodhë i sigurt përmes një reformimi të butë evolutiv, jo kursesit revolucionar.

Fjalët kyçe: gjuhë, komb, standard, njësim, kulturë.

1. Gjuha shqipe - vështrim historik

Historia e kombit tonë është histori 2000-vjeçare Krishterimi. Ilirët përfaquan të parët Krishterimin, që në shekullin e parë pas Krishtit. Kombi shqiptar ruajti me besnikëri e krenari për 2000 vjet fenë e krishterë, gjenezën etnike: zhvillimin e gjuhës, shkrimit dhe letërsisë shqipe, zhvillimet e artit dhe kulturës muzikore; zhvillimet studimore-shkencore, politike si kombi më i vuajtur dhe më i shtypur në Gadishullin Ilirik.

⁷ Revista “Global Challenge” ISSN, botim ADSH, gusht 2012, f. 45-46.

Alfabeti, gjuha dhe arsimit

Në fushën e arsimit u dallua qyteti i Drishtit (afër qytetit të Shkodrës) që në shekujt IV-XV, ku organizoheshin shumë kurse tradicionale të vendeve europiane perëndimore. Mësuesit ishin klerikë⁸. Një pjesë e tyre emigronin në qytetet dalmate, ku shërbenin si priftërinj dhe si mësues. Si vepra e parë e shkruar shqip është “Formula e Pagëzimit” e peshkopit të Durrësit Pal Engjëlli (1462). Në alfabetet e shumta të gjuhës së shkruar shqiptarët zgjodhën alfabetin latin ndër alternativat e alfabeteve fenikase, greke, joniane, arabe, cirilike, hieroglifë dhe të tjera, ku sot nga 2976 gjuhët që ka dhe flet globi tokësor, tre të katërtat përdorin këtë alfabet.

Sot, 127-vjetori i Kongresit të Korilianos (Kalabri) dhe 114-vjetori i Kongresit të Manastirit. Gjuha shqipe: gjuhë e natyrës, gjuhë nga piktogramet (35.000 vjet p.e.s), petrolifet (20.000 vjet p.e.s), ideogramat (15.000 vjet (9000 vjet p.e.s), kuneiform (3200 vjet p.e.s) deri në alfabetet e para të njerëzimit pellazgo-etruske (1500 vjet p.e.s), e rinxjerrë nga pluhuri në Kongresin e Korilianos (Kalabri) 1895 dhe e sanksionuar në Kongresin e Manastirit, si ABC e gjuhës shqipe (1908).

Nga 5000 etni që ka bota, në Gadishullin Ilirik kanë jetuar 153, nga të cilat 53 u kanë mbijetuar shekujve ndërsa të tjerat janë shuar. Qytetërimi i Romës la gjurmë në çdo sektor të jetës, por gjuha shqipe pësoi më shumë se të gjithë, shprehet Shtadmyleri (Stadtmüller). Ndërsa Karl Paç (Carl Patsch) dhe asnjë historian nuk flet për depërtimin e gjakut latin tek ilirët. Kryepeshkopi i Tivarit, Guliem Adami, në vitin 1332 do të shprehej se shqiptarët ndonëse kanë gjuhë më vete dhe ndryshe nga gjuhët latine, megjithatë në marrëdhëniet e përditshme në të gjithë librat e tyre përdorin shkronjat latine.

Si libër i parë deri tani në gjuhën shqipe njihet “Meshari” (1555) i Gjon Buzukut. Vlerësohet edhe poezia dhe përkthimet e Lekë Matrëngës. Poeti i parë konsiderohet Pjetër Budi (1665) me 30 mijë vargje origjinale të shpërndara në veprat e tij të përkthyer. Pjetër Bogdani (1685) la disa fragmente të mrekullueshme poetike. Frang Bardhi (1635) u bë i njohur në letërsinë e kohës. Pjetër Zarishti (1806) ishte i njohur si leksikograf. Në vitet `30 të shekullit të kaluar u bënë të njohur dhe rrëfyes të artë të shqipes Mjeda, Fishta, Migjeni e deri në kohët tona të vona Martin Camaj.

Me ndihmën e Vatikanit, për herë të parë në Shqipëri, më 1638 u çel shkolla e parë fillore e Pllanës në Lezhë me drejtor P. Jacinti e Sospitello. Sipas dokumenteve të Venedikut, këtu mësuan letërsi edhe 5 nxënës të jashtëm, pra logjikisht kuptohet se mund të ketë pasur edhe konvikt. Në 1639 u çel shkolla e Blinishtit po në Lezhë me drejtor P. Karl Mirandlanus O.F.M me 50 nxënës⁹. Në 1698 Filipi nga Shkodra hapi një shkollë private për fëmijët e tregtarëve dhe pasanikëve. At Donat Kurti në një studim të botuar te “Hylli i Dritës” më 1935 flet për të parën shkollë shqipe në vitin 1638. Si të parat shkolla “për sa dijm na”, ai përmend “tri: shkolla e Pldhanës (lexo: Pllanës), e Blinishtit e e Shkodrës”.

Për të parën thotë se është hapur më 1638. Ndërsa studiuesi amerikan Edvin Zhak (Edwin Jacques)¹⁰ në librin e tij të njohur (The Albanians: An Ethnic History from Pre-Historik Times to the Present) i çon shkollat e para shqipe pak më përpara në kohë, në vitin 1632 një dhjetëvjeçar para “shkollës së parë shqipe”(!) të propagandës së diktaturës, në qytetet veriore shqiptare e deri në Durrës, siç nënvizon studiuesi amerikan, “kishte 21 shkolla të tjera fillore shqipe, që zhvillonin veprimtarinë e tyre”. Ai sqaron se secila prej këtyre shkollave kishte rreth tridhjetë nxënës, përveç asaj të Prizrenit, e cila kishte tetëdhjetë. E. Zhak citon një klerik françeskan shqiptar të quajtur Leonardo, i cili, lidhur me thelbin e këtyre shkollave, pohon: “Ne jemi më shumë misionarë të qytetërimit sesa të fesë”.

⁸ Edvin Jacques, “*Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*”, 1996, f. 256-258.

⁹ Burimi: *Orbis beraphicus* T.II.C.N.50 Vatikan.

¹⁰ Edvin Zhak “*Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*”, f. 390-391.

Shkollat ishin fetare, katolike. Katolicizmi ishte pjesë qenësore e identitetit shqiptar. Në këtë hulli është edhe Kuvendi i Arbërit, i mbajtur më 14-15 janar 1703, të dielën e dytë të Epifanisë, në Kishën e Shën Kollit në Mërkinjë të Lezhës. Siç dihet, ai u organizua me nismën e nën kujdesin e drejtpërdrejtë të një pape të madh, Klementi XI, Albani. Dokumentet e këtij Kuvendi historik, që u botuan njëherësh në latinisht e në shqip, treqind vjet më parë, dëshmojnë qartësisht këtë synim, ashtu siç dëshmojnë se njerëzit shkruanin shqip. Historiani amerikan Edvin Zhak në veprën e naltpërmendur shton se më 1877 në qytetin e Shkodrës kishte edhe një “qendër me ndikim për arsimin e lartë, Kolegja e Shën Françesk Savierit, që pajiste me arsim teknik e tregtar rreth 400 studentë”.

Kjo shkollë e lartë ishte edhe një qendër shkencore për krejt Ballkanin, jo vetëm për Shqipërinë. Sipas këtij autori, “një risi shkencore në Kolegjin e Shën Savierit ishte Observatori Meteorologjik, i themeluar aty më 1888, si i pari observator astronomik në Ballkan”. Ky observator, thekson Zhak, “i vazhdoi shërbimet e tij të vlefshme deri më 1946, kur u konfiskua nga regjimi komunist”. Shkolla e parë e lartë shqipe daton të paktën në vitin 1877, kur dokumentohet Kolegji i Shën Françesk Savierit. Dokumentohet kjo datë, por nuk dihet: mund të ketë qenë hapur edhe më parë.

At Donat Kurti thekson se shtypshkronja kishte hyrë në Obot “fill mbas të gjetunit”, domethënë fill pas shpikjes së saj nga Gutenbergu. Shtypshkronja e Obotit, shkruan At Kurti, njihet më 1493. Kjo do të thotë se ajo ishte futur në Shqipëri vetëm 38 vjet pasi Gutenbergu i dha vendit të vet dhe botës prodhimin më të famshëm të krijesës së tij: Biblën e shtypur në shtypshkronjën e vet, shtypshkronjën tjetër të Shkodrës, që njihet më 1563. Studiues të ndryshëm e vendosin Gutenbergun, autorin e kësaj shpikjeje, ndër njëqind njerëzit më me ndikim në historinë e njerëzimit sipas gazetës “Pasqyra”, datë 24 dhjetor 2003 dhe revistës “Diplomacia”, mars 2003.

Rritja e interesit për gjuhën shqipe dëshmohet nga botimi i gramatikës më të hershme shqipe, të shkruar në latinisht nga Andrea Bogdani (1600-1683), ungji i Pjetër Bogdanit. Shkollat e hershme katolike. Shkolla e parë e dokumentuar në gjuhën shqipe u hap në Velje të Mirditës më 1632. Një tjetër shkollë mjaft e hershme ishte hapur në Kurbin më 1632. Françeskanët thuhet se kishin ngritur shtypshkronjën e parë në Shkodër që në vitin 1593. Këto shkolla katolike në Shqipërinë Veriore mbaheshin kryesisht me fondet austriake. Për 350 vjet qyteti u bë i famshëm për shtypshkronjën, të themeluar më 1720, e para në Ballkan pas asaj të Kostandinopojës. “Akademia e Re” u formua në vitin 1744 në Voskopojë.

Ajo pati ndikim të fuqishëm në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe dhe të ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Thesaret letrare të zbuluara në Berat. Libri i parë, i famshmi “Kodex Purpureus Beratinus”, përmban ungjijtë e Mateut dhe Markut, që pretendohet të jenë shkruar nga vetë Gjon Krisostomi (347-407) në kishën bizantine. Më 1866 në Kostandinopojë u botuan veprat e Apostujve në dialektin gegë të shkruara me shkronja latine. Qiriazit, në bashkëpunim me motrën e tij, Sevastinë, hapi shkollën e parë shqipe për vajza në Korçë më 15 tetor 1891. Gjithashtu, shkollës “Qiriazit” iu dha emri i ri Shkolla Amerikane.

Të gjithë shqiptarët e Veriut dhe të Jugut, qoftë katolikë romanë, ortodoksë grekë, myslimanë apo protestantë, ishin të vendosur të bashkoheshin në një komb të vetëm, duke përhapur gjuhën amtare të përbashkët: shqipen. Mbi bazën e Sami Frashërit “një tingull për një shkronjë dhe një shkronjë për një tingull”, ata hartuan një alfabet fonetik prej 36 shkronjash. Temat kryesore të poezive të tij ishin patriotizmi, natyra, ndershmëria, besa, ngjarjet historike, mashtrimi dhe Perëndia. Shkolla e parë u hap më 7 mars 1887. Aty ishin rreth 200 nxënës që mësonin turqishten e shqipen dhe në 1888 u fut edhe greqishtja. Pandeli Sotiri gjeti vdekjen më 1892, gjoja “i hedhur nga dritarja e katit të tretë nga një fanatik ortodoks grek”.

Kur Petro Nini Luarasi u bë drejtor i shkollës, e paralajmëruan se do ta vrisnin dhe ai u përgjigj¹¹: “Vramëni, por gjakun ma mblidhni, sepse do t’u duhet fëmijëve tuaj që të shkruajnë gjuhën e mëmës”. U mbyllën gjithë shkollat shqipe në vend, me përjashtim vetëm të Shkollës Shqipe të Vajzave, e cila falë lidhjeve të saj me protestantët amerikanë, gëzonte njëfarë imuniteti. Kleri ortodoks grek dhe nëpunësit turq kishin rënë në ujdi për ndalimin e literaturës shqipe. Një vajzë thotë: “S’jemi grekër as bullgarë as gjë tjetër nuk jemi, jemi vetëm shqipëtar, ne këtë emër nder e kemi”.

Në vitin 1900 ata e bindën qeverinë italiane që të hapte një katedër të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Napolit. Kurse në qershor 1903 italo-shqiptarët mbajtën në Napoli kongresin e tyre vjetor të katërt, në të cilin u diskutua formimi i një federate, që do të bashkonte të gjitha shoqëritë, dhe inkurajimi i mëtejshëm i botimeve si mjet për të bërë të njohur identitetin e Shqipërisë. Papa Klementi XI, me origjinë shqiptare nga Dukagjini, ngriti në Romë në sheshin “Shën Pjetër” një katedër për gjuhën shqipe, ku përgatiteshin mësues për Shqipëri (me mësues shqiptarë dhe italianë), më 20 prill 1711.

Kjo periudhë përkon me shfaqjen e shqipes më 1777 në gjimnazet e Rosisë, në San Petërburg dhe Novorissk. Pra, shqipja mësohej, shkruhej, këndohej 100 e ca vjet më parë shkollës së Korçës, në kohën e Careshës së Rosisë, Katerinës së Madhe. Në 1716 shkruhet gramatika e parë shqipe nga P. Françesk M. D. Botime të tjera kemi në vitet 1732, 1752, 1842, 1858, 1862, të cilat ruhen sot e kësaj dite në arkivat e Vatikanit. Në vitin 1829 u hap shkolla fillore në Tiranë dhe tre vjet më vonë gjimnazi.

Sipas burimeve amerikane, në vitin 1861 hapet në Shkodër shkolla e parë, e njohur për përdorimin e gjuhës shqipe në kohët moderne. Në 1879 krijohet Shoqëria për Botimin e Shkrimeve Shqip, e përbërë nga shqiptarë katolikë, myslimanë dhe ortodoksë në Kostandinopojë (Stamboll). Në vitin 1892 kemi shkollën e Shkupit në gjuhën shqipe për djem dhe shkollën e Shirokës, ndërsa shkollën e Selcës në vitin 1893 me 50 nxënës. Po këtë vit u hap edhe shkolla e Hotit. Shkolla e Troshanit u çel nga Pjetër Xhadri në vitin 1897 e përsëri në Pllanë më 1868 nga Ndoc Mjeda dhe në 1904 nga Tom Bicaj.

Në vitin 1907 Shtjefën Gjeçovi hap shkollën në Gomsiqe. Në vitin 1900 kemi dhjetëra shkolla, si në Bizë, Iballë, Rrëshen, Orosh, Milot, Dajç, Kallmet, Spaç, Kashnjet, Nedhat, Shirokë etj. Në këto shkolla mësonin priftërinj, fretër dhe civilë në gjuhën shqipe. Në këtë kohë françeskanët kanë pasur 17 shkolla katundi. Në vitin 1879 motrat stigmatine çelën shkollën e parë fillore për femra. Në kujtesën arsimore kanë mbetur emrat e mësuesve Kush Micja, Tone Radoja, Terezë Bërdicja dhe Tina e Nikës.

Në vitin 1885 në Prizren dhe Shkup u çel shkolla e parë e femrave. Vetëm deri në vitin 1911 katolikët kanë pasur në kohë të ndryshme 47 shkolla shqipe. Në veprën monumentale kulturore të Klerit Katolik zënë vend edhe shtypshkronjat. Më e vjetra shtypshkronjë është ajo e Obotit në vitin 1493 dhe ajo e Shkodrës e vitit 1563 (burimi: Narodinia Enciklopedia S.Z.Zagreb 1929). Në vitin 1871 jezuitët sollën në Shkodër shtypshkronjën e parë, me të cilën shtypën mbi 30 vepra deri në 1892.

Në vitin 1908 intelektualët shqiptarë takohen në Manastir të Maqedonisë Ilirike (Bitola), zgjedhin dhe vendosin përfundimisht alfabetin latin dhe jo atë arab, as cirilik. Në vitin 1909 Dom Ndoc Nikaj sjell me shpenzimet e veta shtypshkronjën “Nikaj” që botoi 5 vepra në gjuhën shqipe, deri në vitin 1922. Në vitin 1913 Terenc Toçi me shtypshkronjën “Taraboshi” në Shkodër boton 112 vepra në gjuhën shqipe. Pra, pjesa e veprës kulturore e Klerit Katolik shqiptar, që zë fill që nga “Meshari” i Gjon Buzukut. Shtypshkronja e Obotit dhe natyrisht shkolla e parë shqipe, ajo e Pllanës e vitit 1638, kanë vlera të pazëvendësueshme në historinë e popullit shqiptar.

¹¹ Revista “Diplomacia”, ADSH, Tiranë, 2003, f. 37-38.

Krahas këtyre arritjeve thuhet se sifiziane shqiptare¹² dhe filoshqiptare, kontributi i SHBA-së në arsimin shqiptar është i jashtëzakonshëm. Amerika filloi ta ndihmonte Shqipërinë në arsim dhe kulturë që në fillim të shekullit XX. Në tetor të vitit 1891 Sevastia dhe Gjerashim Qiriazi, të specializuar në shkollat amerikane, hapën në Korçë shkollën e parë për vajza, ku mësoheshin këngë, vjersha, lojna përmendësh dhe ca nga këto luheshin në skenë. Misionari dhe kapiteni Charles Telford Erickson erdhi në Shqipëri në vitin 1909 dhe luajti një rol të rëndësishëm në jetën publike nëpërmjet veprimtarisë arsimore në Shqipëri.

Deri në fund të vitit 1920, KKA në Shqipëri organizoi tri shkolla në Tiranë, Elbasan dhe në Shkodër. Në vitin 1921, ORKKA (Organizata e Rinisë së Kryqit të Kuq Amerikan) u angazhua për shkollën fillore dhe teknike të mesme në Tiranë. Ideja i përket Xhon I. Skalës, anëtar i ORKKA, kurse J. E. Kroli, drejtor i ORKKA, bëri përzgjedhjen e nxënësve. Shkolla Teknike u hap më 20.07.1921. Mësuesi i parë dhe drejtor ishte C. A. Holinshet, pastaj Xh. Majuer, inxhinier amerikan. Mësues shqiptarë ishin Hysen Hivziu, inxhinier Li Cungu, i cili kishte mbaruar Robert Kolegjin në Stamboll.

Gjithçka nën përkujdesjen e mbikëqyrjes së Presidentit, Ahmet Zogu. Në këtë kohë, suksesi i shkollës teknike drejtuar nga Harri Fullsi u ngrit në majat më të larta. Në Korçë shkolla e vajzave drejtohej nga çifti i misionarëve Kenedi. Në fillim të shekullit XX emigrantë shqiptarë në SHBA filluan të vepronin si pionierë të rilindjes kulturore shqiptare: Petro Nini Luarasi mësues, si dhe intelektualët Sotir Peçi, Fan Noli, Faik Konica apo Kristo Dako. Në vitin 1906 Sotir Peçi botoi gazetën e parë në gjuhën shqipe, “Kombi”, në të cilën dhanë kontributin e tyre intelektualët Eftim Naçi, Vani Karameto, Vani Vangjeli.

Më 15.02.1909 botohet gazeta “Dielli” nga shoqëria “Besa-Besë” në Boston, drejtuar nga Noli, i cili jetonte në Nju Jork që më 1906. Për veprimtari intelektuale dhe atdhetare në këtë kohë u shqua Federata Pan-Shqiptare “Vatra” me Sekretar të Përgjithshëm Faik Konicën. Vetëm për 12 vjet në Amerikë u botuan 14 tituj gazetash të përditshme, javore dhe mujore, ku ndër më kryesoret ishte “Dielli”. Nga viti 1880-1908, në botë u botuan 31 tituj gazetash shqiptare, nga të cilat në Belgjikë u botuan 3, në Bullgari 7, në Rumani 4, në Itali 7, në Angli 4 dhe në Austri, Jugosllavi, Greqi dhe Amerikë nga 1. Amerika kontribuoi dhe ndihmoi arsimin, kulturën shqiptare dhe atë ballkanike në përgjithësi.

Kryesisht në disa shkolla: Instituti “Qiriazi” për vajzat në Tiranë, Shkolla Teknike në Tiranë, Shkolla Shqiptaro-Amerikane Bujqësore dhe për Punë Shtëpiake në Kavajë. Në Maqedoni disa shkolla dhe ndër më të njohurat si ajo e Manastirit, kurse në Samakovë më 1861 u themelua një Institut Amerikan. Aktiviteti i KKA, veçanërisht i ORKKA, nëpërmjet Shkollës Teknike në Tiranë, mbikëqyrës i së cilës qe nominalisht deri në vitin 1933, duhet veçuar nga puna e njërive operative. Ndikimi i kësaj shkolle, metodat e mësimit dhe rezultatet që arriti bëjnë pjesë në tërësinë e aktiviteteve, të institucioneve fetare dhe arsimore amerikane në Ballkan, të cilat u përfaqësuan nga Robert Kolegji në Stamboll. Ky institucion arsimor ishte i rëndësishëm për Ballkanin në atë kohë. Sipas Prof. Dr. J. Drançollit, universiteti i parë shqiptar daton më 1380 në Durrës dhe sipas studiuesit Sarë Gjergji, shkolla e parë shqipe daton në Stubëll - Viti të Kosovës, më 1584.

Autoktonia e shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve në raport me ardhësit sllavë në Ballkanin Ilirik

Toponimet (emërvendet) dhe patronimet (emrat familjarë) na qartësojnë etimologjinë shqiptare, gjuhësinë, albanologjinë, historinë dhe gjeografinë. Ne kemi marrë në shqyrtim dy emra: toponimin Tropojë¹³ dhe patronimin Memia. Jashtë kritereve të etimologjisë shkencore ka pasur keqpërdorime dashakeqëse të disa toponimeve që trajtohen si sllave, si: Tropojë (nga

¹² Edvin Zhak, “Shqiptarët” (Vëllimi I), f. 433.

¹³ Qemal Murati, “Shqiptarët dhe Ballkani Ilirik”, Tetovë, 1999, f. 20.

sll. Trebopole), Dibër (sl. Debar), Prishtinë (sll. Pryshtina) të cilat në të vërtetë i takojnë fondit parasllav gjegjësisht atij shqiptar. Toponimin Tropojë* e gjejmë në formën Trejopolja¹⁴. Toponimi Trepolje gjendet dhe në Bosnjë-Hercegovinë në një zonë rrethuar nga Alpet Dinarike që nga koha e neolitit, te dalmatët dhe ilirët. Kurse fjala trepolitët gjendet që në prehistori në Epir.

Studiues të ndryshëm kanë dhënë opsione të ndryshme që shpesh përfundojnë në etimologjinë popullore. Kështu, disa e lidhin me Tropojë, Tropol (qytet i ruajtur, i fortifikuar, i mbrojtur); T'ru pol (pol i ruajtur, pol-boll); T'ru pojë. Një grup tjetër studiuesish shprehen se ky toponim është trako-vlleh. Trop = atë që munda = vend i mundësive. Trop, Tropu - tro - puri - mbartja e njeriut. Pol – polis - polje – poi = qytet, Trop + sinonime. Kemi dhe variantin Tropojë, trupoj (për Gjakovë, Shkodër). Variant tjetër është trapujë dhe trepopa. Sipas studiuesit Albert V. Nikolla, ka etimologji gege: “Träpöj = Trööuj = Shum uj”. “Trop (fr-et.geg.) = Te ra” (duke rënë shumë si: Te ra shi, te ra borë, të ra uj) etj.

Karakteristika fiziko-natyrore e zonës së Tropojës është uji i shumtë dhe rënia e vrullshme nga malet me lumenjtë nga më të pasurit në Europë. Studiuesi Niko Stillo shprehet se mund të ketë lidhje me Moskopojë, Voskopojë, Kostandinopojë, me një shenjt apo vend të krishterë. Duke qenë se ilirët dhe dardanët i bënin fortesat mbrojtëse në gryka të lumenjve dhe maleve që të mos depërtonin pushtuesit sllavë, kemi Junikun, Komin në rrëzë të Shkëlzenit që në shekullin III dhe Tropojën. Edhe studiuesi Fari Xharri shprehet se Tropojë vjen nga fjala polis-qytet dhe duhen hulumtuar arshivat bizantine të Mbretërisë Bullgare të shekujve X-XI.

Edhe profesor Çabej në leksikologjinë shqiptare hedh hipotezën se Tropojë vjen nga polis-qytet. Për formimin gjuhësor të këtij topiku mendimet e studiuesve të ndryshëm të shqipes ofrojnë më shumë në etimologjinë popullore, sipas të cilave ky emërim shpjegohet nga sll. Tri-polje, që domethënë “Tri fusha” ose nga Trebo polje “fushë e hapur, e çelur, punë”, me refleks të lj-së sllave në j. Por një studim të saktë shterues të etimologjisë shkencore të toponimit Tropojë ka bërë Prof. Dr. Qemal Murati mbështetur edhe në faktet historike të arshivave joshqiptare. Shpjegimet e tilla, siç u tha, i takojnë etimologjisë popullore, pra nuk kanë asnjë farë baze shkencore, dhe si të tilla s’janë për t’u mbajtur fare parasys.

Në hetimin e burimit të emrave të vendbanimeve mund të thuhet se është ndjekur deri më tani përgjithësisht një rrugë e gabuar, që është mbështetur kryesisht në fondin e apelativëve, rrugë kjo që ka çuar në rezultate jo të drejta dhe në teorizime dhe etimologjizime të tepërta dhe të pafrytshme, duke lënë kështu jashtë krahasimeve atë më qenësoren, faktet e vërteta shkencore. Në kundërshtim me këtë metodologji, në gjurmimin etimologjik të formimit të emërvendeve ose ojkonimeve, duhet të kihet parasys gjithëherë ky fakt relevant, që këto janë krijuar mbi bazë të emrit personal të themeluesit, kryeparit ose zotëruesit të vendbanimit përkatës, që është kjo një dukuri krejt e zakonshme dhe primare në toponomastikë.

Këtë gjykim shohim ta mbështesë dhe E. Çabej, i cili pohon gjithashtu se “katundet fisnore¹⁵ shpeshherë mbajnë emrin e themeluesit ose të banorit të parë të tyre”. Këtë rrugë e përligj edhe emri i topikut tonë në vështrim, Tropojë, i cili në thelb ruan një emër personal të themeluesit Trepoli/Trepolus, që si një antroponim i këtillë dëshmohej rreth viteve 1330, edhe në librin e notarive të Kotorit, sh.Trepolus (presbiter Triphon Trepoli, të Zbornik Konstatina Jirečeka II¹⁶), me shndërrimin e rregullt konsonantik “l-j”, khs. si të “golë-gojë”, “bilë-bijë”, “malë-majë”, dukuri kjo që ka përfshirë fjalë të një periode më të vjetër të shqipes.

* Tri-polis = tri qyteza (1. Kom - Myhejan. 2. Grac - Shoshan. 3. Rosuj - Dizdar.)

Iliro-dardanët i ndërtuan qytezat në gryka malesh e lumenjsh që të mos depërtonin pushtuesit sllavë drejt Tro(po)jës.

¹⁴ Selami Pulaha, “*Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*”, viti 1974, f. 122. Sqarim: Leximi nuk është i sigurt, mbasi është shkruar pa shenja diakritike. Mund të lexohet edhe Trepopolje. Mendojmë se është Tropoja e sotme.

¹⁵ *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, 1975, f. 337.

¹⁶ *Zbornik Konstatina Jirečeka II*, SANU, Beograd, 1962, f. 206.

Emri vetjak Trepoli/Trepolus, që përmbahet sot te topiku Tropojë, i takon fondit antroponomastik të proveniencës greko-bizantine dhe pas K. Jireçekut¹⁷ gjithsesi rrjedh nga Tryphon, ky një emër kalendarik shenjtor përdorur shpesh në mesjetë në funksion mbrojtës. “Mund të themi se banori i rrënjës nuk mund të shfaroset kurrë”, - shprehet Edith Durham. Ndërsa akademik Idriz Ajeti shprehet se shqiptarët e këtyre trevave nuk mund të njihen të ardhur kur toponimia historike i gjen në këto vise së paku që nga koha pararomake. Ilirologu akademik Aleksander Stipçeviç thotë se shqiptarët janë të vetmit që kanë ruajtur emrat ilirë, emrat e vendbanimeve, madje edhe emrat e njerëzve. Këtë fenomen e vërejmë më së miri në Dardanië Antike, në Kosovë dhe Tropojë.

Gens¹⁸ Memia

Sipas studiuesve F. Vokopola dhe A. Gjoka, familja (Gens) Memia ishte një familje fisnike e njohur në Dardanië dhe në Romë. Anëtar i parë i shquar i kësaj familjeje ishte Gaio Memio Gallo, pretor¹⁹ në 172 para Krishtit. Pas luftës kundër Jugurthas në periudhën e Augustit, bënë pjesë në familjen e madhe të Tribunëve, i cili është emri i disa gjykatësve, funksionarëve e ushtarakëve të Romës Antike.



Monedha e Lucio Memio-s, 106 para Krishtit.

Në pjesën e pasme paraqitet Dea Venere mbi një karro dhe Kupidi sipër saj, duke aluduar kështu origjinën trojane të fisit Memi. Mendojmë se ka ndodhur ndërrimi i tingujve sipas ndikimeve latino-dardane.

(Troëia = troep = troeb = trev) **Trojan = Tro(po)jan**²⁰

Troja²¹ si nekropol i periudhës antike së vonë gjendet në fshatin Spas të Dibrës (AKRM II 123). Është një topoleksëmë e gurrave autoktone. Në toponomastikën shqiptare topikë me apelativ të tillë kemi gjurmë vendbanimesh të moçme, Kërçovë, Laç.

Origjina



Poeti Virgjili pretendonte se familja Memi rrjedh nga heroi trojan Mnestheus. Kjo traditë e vonë sugjeron që në periudhën e fundit të Republikës kjo familje u bë një nga familjet më të rëndësishme të fisnikërisë romake. Chase është i bindur se kjo familje e ka pasur origjinën në Romë. Nga morfologjia e tij, emri mund të burojë

nga një mbiemër²², Memo, kuptimi i të cilit është i panjohur. Përdorimi i Quirinus, një hyjni sabine, në monedhat e Gaius Memio-s në vitin 56 para Krishtit, ndoshta supozohet në një origjinë sabine të kësaj familjeje.

Anëtarë të shquar

- Tito Memo, i dërguari i Senatit romak për të dëgjuar denoncimet e akejeve dhe maqedonasve kundër gjykatësve romakë në 170 p.K.
- Gaio Memio, tribun (gjykatës) romak (tribun=uni i tribus, i pari i tribus) në 111 p.K.

¹⁷ Qemal Murati “Shqiptarët dhe Ballkani Ilirik”, Tetovë, 1999, f. 137.

¹⁸ Gens = Gentes, një grup familjesh që kishin pasur një parardhës të përbashkët dhe ndanin të njëjtin kult besimi.

¹⁹ Pretor = gjykatës romak.

²⁰ Epiteza – Shtesa e tingullit në fund të fjalës (ti-tinë), Troje-po

Epenteza – Shtesa e tingullit në mes të fjalës (andresë – adresë), Troje-Tropeje...

Sinkopa – Rënia e tingullit në mes të fjalës (shpi – shtëpi), Tro(po)je-Troje.

²¹ Qemal Murati, “Shqiptarët dhe Ballkani Ilirik”, f. 135.

²² Emrat latinë ishin tek meshkujt të përbërë nga një paraemër, një emër dhe mbiemër.

- Gaio Memio, gjykatës financiar, në 109 p.K, orator, poet, tribun në 66 p.K. etj.
- Gaio Memio, gjykatës financiar në 56 p.K., tribun në 54 p.K., dënoi funksionarë të ndryshëm për korrupsion. Në 34 p.K. qe konsull suffectus roman për një periudhë kohe.
- Lucio Memio, Gens Galeria, një nga 100 familjet antike më të rëndësishme që nga koha e Romolos, tribun që u ndau tokat veteranëve të Legio VII (Macedonica Paterna) në 41 p.K.
- Publio Memio Regolo, konsull suffectus. Në tetor të vitit 31 pas Krishtit, guvernator i **Maqedonisë**.
- Ishulli Memia, sot ishulli San Giorgio Maggiore, përballë sheshit San Marko në Venecia.

Paremër - (emër i parë) Paremrat kryesorë të përdorur nga kjo familje ishin: Gaio, Lucio, Quinto, Publio dhe një Tito.

Mbiemri - Gjatë periudhës republikane familja Memi përdorte një numër mbiemrash, midis të cilëve: Quirino, emri i të cilit kujton një zot sabin, që identifikohet shpesh me Gianon (latinisht Janus)²³ ose me Romolon. Sipas një interpretimi është mbajtur që të ketë qenë nderuar edhe tek etruskët me emrin Ani.

Busti i Jan-us i ruajtur në Muzeun e Vatikanit

Ishulli ishte pronë e familjes patrice Memo, prej saj mori emrin ishulli Memia. Bardhajt (Memia* + Gashi) janë banorët më të vjetër të zonës së Alpeve Shqiptare dhe të testuar në linjë gjaku i takojnë vijës atërore E-V13>L241>PH2180 e cila gjithashtu lidhet me popujt e fiset e lashta të Ballkanit, me prani prej të paktën 3500 vitesh (epoka e hekurit+) në rajonin ku ndodhet edhe sot. Patronimin Memia para dyndjeve sllave (në shekullin V-VII) para se të ndodhte rotacioni i n-së nga gegnishtja në toskërisht (ranë - rërë - ranishtë) e gjejmë në Vlorë dhe Labëri Meminaj.



Sot, ky mbiemër ruhet në Itali, Mat, Dibër, Tropojë, Mal të Zi, Luginë të Preshevës, Maqedoninë Ilirike, Dardani. Studiuesi Victor Friedman (1997) vëren se emrat e gjërave, fiseve, njerëzve, si dhe format toponimike të lashta nga territoret ilire, krahasuar me format korresponduese të ditëve të sotme, tregojnë se ato kanë evoluar bazuar në rregullat fonetike të shqipes.

²³ Janus (latinisht) – Giano (italisht) i cili është Zoti i fillimit, i materiales dhe jomaterials (ose shpirtërores), dhe që është një nga hyjnitë më antike dhe më të rëndësishme të besimit romak, latin dhe italik. Zakonisht është e treguar me dy fytyra, pasi Zoti mund të shohë si të shkuarën edhe të ardhmen. Ndërsa në rastin që jepet me 4 fytyra, ato janë të drejtuara në katër pikat kardinale. Kemi marrë në shqyrtim toponimin Tropojë dhe patronimin Memia si dy emra që përbejnë simbiozete të përdorura që në lashtësi në mesjetë e deri më sot, në Romë (Itali), Dardaninë Antike (Troja e Epërme). Mbiemri Memia ka lindur si legjendë (p.K.) e një personi, që quhej Memia. Memia ishte i njohur në ato kohë të hershme për ndershmërinë e tij të madhe. Kur edukonin fëmijët për të qenë të ndershëm, prindërit i merrnin, i këshillonin gjithmonë të bëheshin si Memia. Kjo ka vazhduar edhe pas vitit 1344. * Ilirologu i shquar A. Stipçeviq në veprën “*Gli Iliri*” (“Illyrians”; 1966) faktin se Memia ishte kryelajmëtari i Mbretit Gent (181-168) p.e.s. Ndërsa tek albanologu Han del i pari i Gashit një i Bardhaj (1557) (Memi- Bardh- Gashi). Sipas etimologjisë popullore fj. vj. - Gash- rrjedh nga gur- gac= gur- gash= gash- guri. Rendi i vendosjes së fjalëve në shqipe është i lirë. Fjalën *gur* e gjejmë edhe në Bibël (M. Zeqo). Ndërsa, mbretërit dhe mbretëreshat u jepnin këshilltarëve të tyre më të besuar titullin Memia. Mbiemri Memia ishte mbiemër i një familjeje fisnike romake, ku sipas Thunmannit, qytetarët e vjetër të Romes i tregonin atij ilirët e lashtë. Si familje parie u përjetua në telat e lahutës: “Për armë serme e bujari, Del n' Memi t' Gashit t' Gurit, n' Malësi t' Tropojës e krejt Dardani”! Në fillim të shekulli XX (në kullën Memia në Myhejan), u strehua një muaj, ideologu i Rilindjes Kombëtare, burrështetasi Hasan Prishtina që përndiqej nga Perandoria Osmane.

2. Udha e gjatë në shekuj e gjuhës shqipe drejt standardizimit

Formimi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar, si varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, ka qenë një proces i gjatë, që ka filluar që në shekujt XVI-XVIII, por përpunimi i saj hyri në një periudhë të re, në shekullin XIX. Shkrimtari i madh I. Kadare²⁴ e quan Kongresin e Manastirit të vitit 1908 si fillimin e gjuhës standarde. Në këtë Kongres, me kryetar gjeniu e letrave shqipe Gj. Fishta, nga 42 alfabetet që u paraqitën u vendos që të përdorej një alfabet i ri, i mbështetur tërësisht në alfabetin latin, i plotësuar me nëntë diagrame (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh) dhe me dy shkronja me shenja diakritike (ç, ë), është alfabeti që ka edhe sot në përdorim gjuha shqipe. Me studimet etimologjike të gjuhës shqipe janë marrë Thunmani, Malte-Bruni, Pouqueville, Xylanderi, Hani etj. Më parë se këta, gjeniu Leibnitz pat shkruar kriterin se në gjykimin e karakterit të shqipes duheshin veçuar elementët e vendit nga elementët e huazuar dhe me këtë vizion vazhdoi kërkimet shkencore që ndoqi vetvetiu.

Rrugë që vazhdon të ndjekë edhe sot gjuhësia e më pastajme. Albanologu Franc Boppi²⁵ (1854) me të drejtë vuri për bazë parimisht format gramatikore. Mbështetur në metoda dhe parime shkencore të mirëfillta ishte i pari që u shpreh se ndikimi i gjuhës latine në gramatikën shqipe ka qenë 0. Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane të folura në trevat nga India në Europë që në kohët e hershme parahistorike. Me burim të përbashkët, kjo familje dallon nga gjuhët semitike dhe ugro-fine që kanë fjalor të trashëguar dhe sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore.

Si gjuhë të vdekura mund të përmendim hetishtja, tokarishtja, trakishtja dhe frigishtja. Gjuha shqipe është gjuhë e gjallë që shfaqet në të gjitha nënsistemet e saj: në fjalor, sistemin fonetik dhe strukturën gramatikore. Gjuha shqipe ka ruajtur tiparet e saj thelbësore pavarësisht trysnisë në shekuj të greqishtes, latinishtes, sllavishtes dhe turqishtes. Hulumtimi dhe studimi i fazave parashkrimore paraqet vështirësi. Një kontribut të veçantë ka dhënë Faik Konica i cili hyjnizon prejardhjen e shqipes si gjuha më e lashtë e Europës dhe pasardhëse e gjuhës pellazge. Vepra kapitale teoriko-gjuhësore e Konicës mbetet “Ese për gjuhën natyrore dhe artificiale”, botuar më 1904 frëngjisht me pseudonimin Pyrruhs Bardyli.

Gjuha shqipe si gjuhë natyrale e vjetër ka ruajtur dhe përdorur fjalët njërrokëshe. Përmes onomatopesë paraqitet tingulli përmes fjalës përgjithësisht monosilabuese që në krijesat e hershme të tingujve të parë parahistorikë. Onomatopetë dhe fjalët njërrokëshe, fosilet e para të inteligjencës dhe kujtesës njerëzore për të komunikuar dhe për të krijuar komunitet lindën ndër trojet tona. Fjala është gjuhë në veprim, përdorimi i gjuhës për qëllime komunikimi. Gjuha dhe e folura presupozojnë detyrimisht njëra-tjetrën dhe formojnë një unitet dialektik²⁶. Gjuha natyrore është gjuha e fjalëve.

Fjala barazohet me një shenjë dhe gjuha përkufizohet si një sistem i veçantë shenjash, dhe të folurit është komunikim i bazuar në këtë sistem. Ideja e Konicës për krijimin e një gjuhe të përbashkët ishte origjinale, ishte ajo e përzierjes a shkrires së dy dialekteve. “Të marrim pakë nga të tëra nënëgjuhërat”. Bazat e shqipes standarde ishin hedhur që në 1916 nga Komisia Letrare e Shkodrës e vlerësuar mund të thuhet e para akademi shqiptare e shkencave dhe e artit. Dijetarë të mëdhenj nga Veriu e Jugu: Gj. Fishta, Ndre Mjeda, L. Gurakuqi, A. Xhuvani, Hafiz Ali Korça, Sali Nivica, Sotir Peci patën bashkëpunim e mirëkuptim.

²⁴ Qemal Murati “Për shqipen standarde”, Prishtinë, 2009, f. 47.

²⁵Eqrem Çabej “Studime etimologjike në fushë të shqipes I”, f. 29.

²⁶ Ferdinand de Saussure në “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme”, i ndau konceptet e “gjuhës” (gjuhës) dhe “të folurit”, (lirimi me kusht) si të papajtueshme, e ndau shkencën e gjuhës në gjuhësinë e gjuhës dhe linguistikën e të folurit. Por, më vonë shkencëtarët arritën në përfundime se pavarësisht dallimeve, ekziston edhe një lidhje dialektike (veprat e gjuhëtarëve të shquar A. Sechet, G. Guillaume, A. I. Smirnitsky, L. V. Shcherba, Zvegintsev, Katsnelson, Meshchaninov etj.).

Këta studiues ishin albanologë të përmasave europiane. Vendimet e Komisionit Letrar Shqip për gjuhën letrare e për drejtshkrimin e saj u miratuan më vonë edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe vijuan të zbatoheshin deri në Luftën e Dytë Botërore. Kontribut të veçantë dhe ndihmë në hartimin e rregullave si gjuhëtarë dhanë studiuesit Maximilian Lambertz (1882-1963) i Vjenës dhe akademiku Rajko Nachtigall (1877-1958) i Gracit të Austrisë. Standardi kishte në themel të folurën e Elbasanit si urë lidhëse për dy dialektet kryesore për të gjithë Jug-Veri.

Rregullat e përcaktuara nga Komisia e hapnin edhe më shumë. Ky standard u kishte mbijetuar disa qeverive të majta e të djathta dhe dy luftërave botërore. Nuk ishte i përsosur, por kishte hapur hulli nëpër të cilën po ecej, po shkohej drejt përsosjes. Gegnishtja i ka pas rregullat e drejtshkrimit para se me i pas shqipja e sotme standard²⁷. Gegnishtja ka 4 nëndialekte: shkodranishten, kosovarishten, nëndialektin e Shqipërisë së Mesme dhe nëndialektin e Dibrës, Tetovës e trevave përreth. Edhe toskërishtja ka 3 nëndialekte, por s'duhet ngatërruar me dialektin sepse sjell pështjellim në gjuhë. Gegnishtja dhe toskërishtja janë 2 mushkëritë e gjuhës shqipe. Dialekti i Elbasanit u bë gjuhë zyrtare. Elbasanishtja nga pikëpamja morfologjike ishte toskërishtja, kurse nga pikëpamja fonetike ishte gegnishtja, këtu shkriheshin dy dialektet në një.

Kjo gjuhë zyrtare vazhdoi deri në 1946 kur Ministria e Informacionit dhe e Propagandës, që drejtohej nga Sejfulla Malëshova, dha urdhrin që të mos respektohej gjuha zyrtare. U kundërshtua nga A. Xhuvani të cilin e mbështeti edhe Çabej, por u realizua pas vdekjes së Xhuvanit në Kongresin e Drejtshkrimit, 1972. U injorua fakti që gjuha standarde, elbasanishtja, ishte përdorur 30 vjet (1916-1946) në Shqipëri dhe 50 vjet në Kosovë e trojet e tjera jashtë Shqipërisë politike. Sipas Konicës, gjuha dhe karakteri pasqyrojnë njëra-tjetrën dhe se letërsia jonë popullore është ruajtur dhe përcjellë vetëm nga gratë e fëmijët dhe nuk mund të mos merrte veçse formën naive të gjuhës së tyre (Albania 1, 1905). Arritjet u evidentuan edhe në leksikografi.

Historia e leksikografisë shqiptare

Historia e leksikografisë shqiptare shqipe që i ka kaluar 360 vjetët ndahet në 2 periudha:

Fjalorë dygjuhësh

**Fjalori serbokroatisht-shqip (1947) i hartuar nga V. Dançetoviç, A. Xhuvani, K. Cipo, E. Çabej. Fjalori rusisht-shqip (1954). Fjalori italisht-shqip (1986) i hartuar nga Ferdinand Leka e Zef Simoni, me rreth 50.000 fjalë.*

**Daniel Xhoxhaj: Hyrje në leksikografi - Makrostruktura²⁸ e mikrostruktura²⁹ e fjalorëve shpjegues shqip e frëngjisht. (2000)*

**Fjalori frëngjisht-shqip (1966; 1989) dhe Fjalori shqip-frëngjisht (1977; 1998) i hartuar nga Vedat Kokona. Fjalori gjermanisht-shqip (1998) i hartuar nga Ali Dhrimo, me rreth 45.000 fjalë. Fjalori anglisht-shqip (2000) i hartuar nga Pavli Qesku, me rreth 70.000 fjalë.*

**Fjalori shqip-anglisht (2002) i hartuar nga Pavli Qesku, me rreth 45.000 fjalë. Fjalori shqip-italisht (2003) i hartuar nga Ferdinand Leka e Zef Simoni, me rreth 40.000 fjalë.*

²⁷ Mehmet Elezi, "Gjuha shqipe me një mushkëri".

²⁸ "Makrostruktura është tërësia e njësisë leksikografike të renditura që i nënshtrohen gjithmonë një leximi vertikal të pjesshëm për gjetjen e objektit të mesazhit". - J. R. Debove, "Etude linguistique et semiologique des dictionnaires francais contemporains", La Haye, 1971, f. 21.

²⁹ "Mikrostruktura e fjalorit është ndërtimi i çdo njësisë leksikografike veças, ç'përmbledh ai që quhet "zë leksikografik" a paragrafi i fjalës". - J. Thomai, "Leksikografia e gjuhës shqipe", Tiranë, 2006.

Fjalorë njëgjuhësh

**Fjalori i gjuhës shqipe (1954) me rreth 25.000 fjalë. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980) me mbi 40.000 fjalë dhe 7000 njësi frazeologjike.*

**Fjalori i shqipes së sotme (1984), me rreth 34.000 fjalë. Fjalori i gjuhës shqipe (2006) u hartua nga Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Thanas Feka, Valter Memisha dhe Artan Goga, me rreth 48.000 fjalë.*

**Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe (1999) i hartuar nga Jani Thomai, me mbi dhjetë mijë njësi frazeologjike. Fjalori i antonimeve të gjuhës shqipe (1999) i hartuar nga Miço Samara, me rreth 2000 çifte antonimesh. Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, me rreth 29.000 fjalë, i hartuar nga Jani Thomai, Miço Samara, Hajri Shehu, Thanas Feka. Fjalori i gjuhës shqipe me 41.000 fjalë i M. Elezit, nuk ka marrë, deri më sot, vlerën që mbart nga ASHSH.*

**Përkrahim nismën e Qendrës për Edukim dhe Përparim të RK-së për projektin e hapur të Fjalorit të madh drejtshkrimor të shqipes me 100.000-200.000 zëra me 300.000 faqe, me synimin e qartë “Një komb një gjuhë, një standard, një softuer”.*

Para Kongresit të Drejtshkrimit që u mbajt në Tiranë (në nëntor të vitit 1972), ngjarje me rëndësi ishte Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, 22-23 prill 1968, mbështetur në rregullat e drejtshkrimit (projekt) të botuar 1 vit më parë në Tiranë (1967). Duhet theksuar se dijetarët e Kosovës votuan si shqiptarë dhe jo si gjuhëtarë. Mbështetur në idetë iluministe të revolucioni francez të fundshekullit XVII në “planin Talleyrand” ku për herë të parë do të bashkojë në një gjuhën dhe kombin: “Një gjuhë, një komb”.

Studiuesit dhe gjuhëtarët e Kosovës dhe të trevave jashtë Shqipërisë mbështetën fjalën e shkurtër, por impesive të historianit Ali Hadri³⁰ me titull “Një komb, një gjuhë letrare” e cila u bë moto e gjithë konsultës. Edhe pse patën kundërshti nga një grup i vogël studiuesish për të qenë më përfshirëse gjuha e gegnishtes, vendimet që u morën në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës patën rëndësi kombëtare sepse bindi joshqiptarët që në mbarë trevat etnike kemi një gjuhë unike dhe një komb (1968, Kosovë). Ishte veprim i lartë atdhetar për të ruajtur njësinë kombëtare e historia do t’ua mbajë mend për mirë.

Ndërsa në Kongresin e Drejtshkrimit 1972 morën pjesë studiues nga të gjitha trevat, por sigurisht me përzgjedhje dhe nuk u ftuan dijetarët e mëdhenj, si: S. Riza, At Valentini, M. Camaj, A. Pipa. Në kongres nuk pati debat shkencor as të lirë, gjithçka ishte e përcaktuar. Më vonë u provua për t’u “përkthyer” në shqipe standarde Cikli i Kreshnikëve, kanuni i mbledhur prej Gjeçovit, proza popullore nga Drenica të Anton Çetës dhe u bë e pamundshme sepse mjetet gjuhësore të këtyre veprave nuk i ka standardi. Folësve nuk mund t’u imponohet kurrfarë të folmeje, por akademitë dhe institucionet arsimore e kulturore lypset t’i përgjigjen saktësisht këtij niveli që po jetojmë në shekullin e shqiptarëve. Në një standard gjithëpërfshirës dhe të mirëstudiuar shqipja “shpëton” edhe nga prurjet e shumta të gjuhëve të tjera pa qenë nevoja.

3. Standardizimi, reformimi dhe pasurimi i shqipes

Në gjuhësinë moderne standardizimi i gjuhës është një fushë me rëndësi prioritete sa i përket përmirësimit të gjuhës për qëllime letrare e shkencore. Fenomeni i globalizmit dhe rënia e Murit të Berlinit ka bërë që ndryshimet politike në Shqipëri të shoqërohen me lëvizjet e mëdha të shqiptarëve si brenda Shqipërisë, ashtu edhe drejt njëri-tjetrit në mbarë Gadishullin Ilirik e drejt Perëndimit.

³⁰ *Philosophica* (International Journal of Social and Human Sciences), vol. 5, Tetova, 2018, f. 13.

Ky ndryshim gjeopolitik ka ndikuar në pozitivitetin e krijimit të sociolekteve të një “përzjerjeje të folmesh” drejt zgjerimit të gjuhës standarde e çlirimit nga “gjuha e drurit”³¹ për t’u larmue me prurje nga dialekti gegë dhe arbëresh. Fenomeni gjuhësor “prerja e realitetit” përmes tingujve e shkronjave që në femini u godit nga “gjuha e drurit” e dogmave, e propagandës ideologjike m-l; -agjitacion dhe propagandë: agallarë, bejlerë, kulakë, aksion me goditje të përqendruar, frymë revolucionare, ambientit mikroborgjez e parulla të tilla pa fund që synonin të krijonin “njeriun e ri” modern... Njësimi gjuhësor është vetëdijesim i përbashkët shoqëror, kulturor e gjuhësor që kthehet në pjesë përbërëse të çdo individi.

Por kjo nuk mund të arrihet me një të rënë të lapsit apo me vendim qeverie, kur dihet fort mirë se mbi gjysma e popullsisë shqiptare ndodhet jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Pra, njësimi gjuhësor vështirësohet edhe më shumë. Mosmarrja parasysh dhe në konsideratë e faktorëve jashtëgjuhësorë, psikikë dhe atyre sociolinguistikë solli një aksiomë jo gjoja një njësimit mbarëgjuhësor suis generis, që faktikisht nuk paraqiste të vërteten nga terreni, individi, komuniteti e shoqëria përherë e më shumë në lëvizje e progres kontemporan.

Këto 3 dekadat e fundit formimi i vetëdijes gjuhësore kombëtare ka krijuar një përfytyrim të ri dhe shpresëdhënës për një lëvizje të madhe, të mirëmenduar e të mirëstudiuar panshqiptare. Në altarin gjuhësor të shqipes mikrolinguistika po prish tabutë dhe po krijon pamje me imazhe e performancë të pakonceptuar më parë. Prandaj standardi, gjuha e gazetave, siç shprehet akademik Bahri Beci, nuk duhet parë si më parë, si e pandryshueshme. Larmia e varieteteve e bën mozaikun e gjuhës më shprehës sidomos në ligjërimin publik e letërsinë e shkruar.

I njëjti fenomen gjuhësor ndodh edhe me anglishten, anipse është një përzjerje e madhe e shumë gjuhëve mes veti, ajo në ditët e sotme po rritet ende duke marrë fjalë nga gjuhët e ndryshme të botës. Me lindjen e sociolekteve rigjallërohen fjalë e struktura dialektore të të folmeve të përdorme më parë në standard si p.sh. kahmot³², pash Zotin, lisi i t’amblit etj. Krijimi i fjalëve të prejardhura: imazh- imazhbardhë, paqebërës, paqedashës, i pamatë, i pacak etj., është një botë e pasosune... Kjo tendencë vihet re edhe në gjuhët e quajtura të mëdha.

Kështu, në Francë, në shekullin XX e sot, zhvillimet e brendshme të gjuhës, anipse frëngjishtja parisienne mbetet normë, konsiderohen si proces i natyrshëm dhe është gjuhë e dytë në botë pas anglishtes në të mësuar. Akademitë gjuhësore, studiuesit lypset të marrin nisma për të ofruar leksik të ri dhe kjo asimilohet kur pranohet dhe përdoret nga publiku dhe qytetarët. Edhe italianët, përmes kryeveprës “Komedia hyjnore”, rizbuluan gjuhën e tyre në formë sublime dhe e ngritën në gjuhë standarde, ndërsa gjermanët gjuhën e Biblës në përkthimin e Luterit. Sot italishtja pasurohet çdo ditë dhe njihet si një nga gjuhët zyrtare të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara.

Pra, kombet e qytetëruara kanë bërë standardizimin e gjuhës, gjykuar mbi vlerat gjuhësore dhe vetëm mbi ato. Lypset të mirorganizohet një kuvend në nivel mbarëkombëtar si dhe me kontributorë studiues ndërkombëtarë për një strategji të saktë drejt plotnisë së gjuhës shqipe. Lypset të mësohet gjuha shqipe në shkolla, krahas trajtave të toskërishtes standarde, të jepen edhe njohuri të plota edhe për trajtat përkatëse në gegnisht. Reformimi i standardit të përfshijë krejt qenien e gjallë të gjuhës: strukturën gramatikore, sintaksore, fonologjike, leksikon (fjalësin), frazeologjinë.

Reformimi me kritere shkencore të përfshijë: dijetarë, njerëz të letrave që kërkojnë ndryshime. Të konsiderohen albanologët dhe veprat e studiuesve: Selman Riza, At Valentini, Petro Zheji, Dh. Kamarda dhe më shumë Çabej i cili nuk e mbështeti asnjëherë standardizimin në mënyrën si u veprua dhe u bë. Për të mbrojtur gjuhën shqipe duhen fuqizuar dhe pasuruar vlerat e mohuara për shkaqe jashtëgjuhësore. Ide kjo e Çabejit prej më se 50 vjet më parë.

³¹ Shezai Rrokaj, “Shqipja në epokën e globalizmit dhe identiteti i saj”, revista “Imazhi Shqiptar”, Botimi FIM; Tiranë, 2009, f. 10-11.

³² Revista “Diplomacia”, ADSH, prill-qershor 2001, f. 64.

“Midis gjuhës ekzakte të shkrimtarit e gjuhës së gjallë popullore, ne duhet të mbajmë një rregull të mesme”³³. (Përndryshe gjuha shqipe mund të jetë gjuhë e papasuruar dhe e prapambetur). Çdo vit në Francë një grup akademikësh përgatisin fjalor “Robert” të përditësuar me fjalë e kuptime ose shprehje të reja. Gjuha ka nevojë me u standartizue dhe të reformohet thelbësisht e pafundësisht. Të zëvendësohet përjashtimi me gjithëpërfshirjen, gjithëpërfshirja të jetë “shumëpërmbarsore”

Pa gjuhë shqipe nuk ka shqiptarë

Duhet të mirëpërdorim, mbledhim çdo shkronjë e tingull të gjuhës shqipe, jo vetëm në hapësirën e botës shqiptare në Gadishullin Ilirik, por edhe në mërgatën e vjetër të arbëreshëve, arvanitasve e në mërgatën e re të ditëve të sotme në të gjithë planetin.

Pse kjo vëmendje për gegnishten e normëzuar? (të metat)

Varfëria e standardit është dëshmuar në shqipërimin e kryeveprave botërore. Përkthyesi Gjon Shllaku pasi shqipëroi mjeshtërisht “Iliadën” prej gjuhës origjinale pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972) iu vu detyrë që të njëjtin përkthim ta kthente në gjuhën standarde për një botim të ri. Rezultati tregoi se kryevepra e Homerit doli 10 faqe më e gjatë.

Përveç zëvendësimit të grupit ue me ua, r-të me n apo â-të me ë, një numër fjalësh dhe shprehjesh frazeologjike të gegnishtes u zëvendësuan me parafrazime. Në një intervistë të dhënë për televizionin “ATN” para se të ndërronte jetë, vetë Gjon Shllaku u shpreh se ky ripunim i kishte kushtuar 9 vite të tjera pune dhe se ishte habitur shumë kur i dolën 327 vargje më tepër. Pra, konkluzion është se fuqia e mjeteve shprehëse në gjuhën shqipe në dialektin e gegnishtes është më e plotë se mjetet shprehëse në standard. Fishta i njohur e i shikuar në Jug e Veri u bë i pakuptueshëm për brezat që po edukoheshin me standard dhe jo me krijimtarinë e stilistëve të përkryer N. Mjeda dhe E. Koliqi. Robert Elsie e përktheu anglisht veprën e Fishtës kurse në gjuhën shqipe standarde është e pamundur për t’u “përkthyer”. Një reformim i sfondit pa ia çënu bazën është jetik. Në vende të ndryshme, si në Itali, njerëz të letrave shkruajnë në dialekt. Ndërsa ligjërimet publike përmes përdorimit të dialekteve në Zvicër³⁴ shihen si cilësi elitare. Ka që shkruajnë edhe në nëndialekt.

Gjuha si kryevlerë e identitetit kombëtar shqiptar, a po i mohohet liria?! Pse?

Çfarë mund të përmirësohet?

Të metat që mund t’i përmirësojmë mbështetur në etikën shkencore të studimeve gjuhësore moderne e albanologjike diakronike, si dhe në përvojën e gjuhëve “të mëdha”. Hulumtimet kërkojnë planifikime e analiza të thella dhe jo emocione subjektive të votuesit e studiuesit se i pëlqen jashtë ligjeve të brendshme të zhvillimit të gjuhësisë. Mjaft mirë mund të bashkëjetojnë 2 trajta me elemente të toskërishtes dhe gegnishtes brenda 1 fjale.

³³ Mehmet Elezi, “Gjuha shqipe me një mushkëri”, “Heshtje varri për një djep të shenjt” (publicistikë), “Drejtshkrimi i gegnishtes ose gegnishtja e standartizuar”.

³⁴ “Me kenë me pasë me mujtë me shku me i thanë me ardhë me m’pa”. Kjo fjali e përdorur nga i ndriçmi Luigj Gurakuqi me shtatë paskajore pa asnjë pjesë të ligjëratës, qoftë edhe lidhëz, është unike dhe ndihet së brendshmi muzikaliteti i saj. Duke e vlerësuar infinitivin, pra paskajoren, si kulmin e abstragimit gramatikor në sistemin foljor të një gjuhe, lind pyetja: Meqë ne e kemi që në fillesa, përse të mos e rikonsiderojmë?! Paskajorja përdoret për të formuar edhe mënyra të tjera të foljes, se dëftoren, urdhëroren, lidhoren. Sqarim: Nuk u është kushtuar vëmendja veprave të vjetra të letrave shqipe, 5- “B”- ve, siç thuhet në zhargonin e rëndomtë (Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi, Baleti). Frang Bardhi para se të na njoftojë me “Letren e Krenve të Gashit drejtuar Vatikanit” (1689) qe shpreh se “gluha skype po dbardhet e dastadhohet”, po, sot, si?...

Themi mësues, e jo mësonjës, shikues (mësue, shikue) në të njëjtën fjalë kemi 1 pjesë (element) të toskërishtes (varfër kundrejt vorfëri) e një pjesë e gegnishtes pjesorja me ue (varfërues). Pra, mund të jetojnë 2 trajta të pjesores meqë jemi brenda shqipes. Pjesorja geqe merr vlerën e saj. Sipas Fishtës e Naimit, fjala ndryshon prej fjalës e duhet sa më thjesht, se fjalët e huaja e shëmtojnë gjuhën shqipe. Gjuha shqipe si do gjuhë të quajtura “gjuhë të mëdha” konkurron me to në të gjitha strukturat gjuhësore si dhe për leksik e abstragim. Shkrimtarët dhe njerëzit e letrave nuk duhet të vuajnë nga vetëcensura dhe të mos kenë frikë se nuk kuptohen fjalët e reja shqipe dhe në vend të tyre të përdorin të huaja të panevojshme. Një gjuhë ndrit në shqiptimin sa më elokuent të fjalës, togfjalëshit dhe frazës.

Kështu në frëngjisht tingulli -s- mes dy zanoreve shqiptohet -z-. Te fjala në shumë les hommes, dhe pse -s- s’është mes dy zanoreve por ka -h- (muet) për të mos mbetur goja hapur (pour la prononciation) për të mirëtingëlluar e lehtëshqiptuar lexohet: - lezom (burra), ndërsa tek fjala les héros, shqiptohet le- ero dhe jo lezero se do të pështjellohej nga heronjtë në zerot. Po kështu edhe në anglisht kemi: it is not (nuk është), ndërsa për lehtësi (pronunciation) shqiptimi thuhet it’s not dhe gjuha lëviz lirshëm në gojë e fjala rrjedhshëm, shpejt, qartë e kuptueshëm.

Ky fenomen që të mos mbesë goja hapur dhe të mos ketë mungesë etike në komunikim (pamja e dhëmbëve) gjatë bashkëbisedimit me dikë apo në të folurit publik eliminohet nëse përdoret gegnishtja në vend të toskërishtes kështu: -dua të të them- do ishte shumë më e mirëshqiptur me një tingëllim muzikor dhe lehtësisht në shqiptim pa i sforcuar buzalet, as organet e artikulimit, ezofagun e laringun duke u shprehur në gjuhen gegënishte: - Due me t’ than. Pra, gegnishtja eliminon fenomenin e hiatit me antihiatizimin e, shkurt-shqiptimit, të apostrofit dhe përdorimit të bashkëtingëlloreve në mes dy zanoreve për të eliminuar defigurimet e imazhet e mimikës së fytyrës së folësit.

Nga arritjet e gjuhës ndër më të rëndësishmet janë: idiomat, shprehjet frazeologjike dhe mirëpërdorimi i onomatopeve, emri e shqiptimi përmes tingëllimit dhe fjalët njërrökshe që në prehistori, para shkrimit. Këto gjenden me shumicë jashtë standardit në gegënisht, arbërisht, mërgatë e në mbarë elementin protoshqiptar në Gadishullin Ilirik. E metë tjetër është edhe mosfunktionimi në shtratin e vet të infinitivit, pjesores dhe paskajorja. Kështu, në frëngjisht mësuesi i thotë nxënësit: “Conjuez le verbe parler, au présent de l’indicatif à la forme affirmative, au premier personne du singulier” = Zgjedhoje foljen me folë (jep kuptimin pra), në kohë e tashme të mënyrës dëftore, numri njëjës, veta e parë. Dhe nxënësi fillon zgjedhimin: Je parle = unë flas, që ndryshon nga forma e infinitivit, pra, kemi parler dhe je parle...

Kurse në shqipen standarde ndodhi ndryshe, që përben një defekt i cili kërkon angazhim e përmirësim sa më të shpejtë. Kur mësuesi i jep të njëjtin ushtrim nxënësit, keqësisht me detyrim standardi ia parashtron të zgjidhur. Kështu kemi: “Zgjedhoje foljen punoj në kohën e tashme, mënyra dëftore, veta e parë, numri njëjës”... Faktikisht, mësuesi i detyruar për t’i qëndruar strikt rregullave gjuhësore të standardit, jashtë përgatitjes së tij profesionale dhe vetëdërgjegjësimit ia ka dhënë pyetjen e rastit, pra ushtrimin të zgjedhur dhe nxënësi fillon: (unë) punoj, ti...

(Sh)përdorimi i një zanoreje si ë-ja pazane meriton vëmendjen e duhur, përdorimi i së cilës në standard shkon deri në inflacion. Është një problem teknik që kur t’i vijë radha lypset të rivlerësohet. Mendoj t’i rrihet besnik sistemit me dhjetëshe 30-40-50 në të gjitha trevat e jo të përdoret (eksepsioni) përjashtimi nga rregulli i sotëm i shqipes, anipse një shtresëzim i hershëm si gjurmë e toskërishtes me 20-she. Të mirëstudionet e mirëpërdoret aksenti i shqipes parafundor (paroksiton: káfe dhe jo kafé), si dhe të shkruhen siç shqiptohen emrat e huaj (jo Shakespeare e J. J. Rousseau, po Shekspir e Zh. Zh. Ruso).

Ka mendime të ndryshme për ortografinë për fjalët: kuzhinë apo guzhinë, standart apo standard, që imponohen gjerësisht në kryeqendrën e shqiptarizmit në Tiranë. Pra, sot Tirana si metropol i lëvizjeve të qytetarëve³⁵ nga mbarë trevat shqiptare, si kryqëzatë e zhvillimeve ekonomike, politike, sociale, sociolinguistike ka marrë rolin e shkrirjes së koineve, dialekteve, gjuhëve, nëndialekteve, krahinorizmave, arkaizmave, neologjizmave, terminologjisë së nanoteknologjisë, mediamorfozës dixhitale, përbën shkrirjen drejt një gjuhe standarde të formuar në plotninë e saj kombëtare. Pra, sot Tirana në kohë moderne po zëvendëson gjuhën standarde zyrtare të elbasanishtes (pas 1916-1946).

Lypset që me mirëkuptimin e albanologëve, studiuesve dhe gjuhëtarëve të mos keqpërdoret me padashje fjala “shqipfolës”. Shqipfolës nuk është e barabartë me shqiptar. Gjuha te shqiptarët, ndryshe nga etnitetet e tjera, është identiteti genetik i etnogjenezës së ADN-së shqiptare. Në botë ka miliona anglishtfolës që nuk janë anglezë, miliona frëngjishtfolës që nuk janë francezë. Nuk duhet të ngatërrojmë fjalët shqiptar me shqipfolës si dhe termat e terminologjinë e tyre. Një shqipfolës mund të jetë edhe shqiptar, edhe shqiptarofil, edhe shqiptarofob. Kurse fjala “shqiptar” përcakton në radhë të parë përkatësinë kombëtare. Fjala “shqipfolës” tregon aftësinë për të folur shqip.

Shqiptarin dhe shqipfolësin i bashkon vetëm fakti që të dy mund të merren vesh duke folur të njëjtën gjuhë. Studiuesi M. Elezi shprehet se është e patolerueshme përdorimi në masmedia dhe nga politikanët, le më pastaj nga shkencëtarët, i frazave dhe togfjalëshave se... në krahinat shqipfolëse të Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi... jo dhe jo, kjo duhet të marrë fund njëherë e mirë. Gjuha shqipe në të gjitha trevat po pëson ndryshime marramendëse. Një hapje mbështetur në kritere shkencore për pasuritë e gjuhës shqipe të gegnishtes, arbërishtes dhe prurjeve bashkëkohore të përjashtuara për arsye jashtëgjuhësore do ta shëndetësonte gjuhën shqipe, do t’ia forconte imunitetin dhe mbushte me energji të reja në plotninë e saj.

Lëvizjet, vdekjet natyrore të brezave, lëshimi i fshatrave drejt globalizmit kanë sjellë shumë humbje në të gjitha aspektet, edhe në gjuhë. Standardi duhet të ketë të paktën atë fuqi shprese që ka vetë gjuha. Shqipja ka përkatësi e vetvetësi. Po të flitej një gjuhë tjetër në mbi 8 milionë shqiptarë në Ballkanin Ilirik, duhej të bëhej ADN-ja e tyre për t’u quajtur shqiptar, këtë e mbulon shqipja. Gjuha shqipe për shqiptarët është më tepër se çështje e gjuhës amtare, në ndryshim me disa kombe, rasti i anglishtes (e shumë përvoja të huaja). Jashtë fjalorit fjalët e gjuhës shqipe përdoren gjysëm e deri në ¾ të hapësirave.

Fjalët prej qindra vitesh të krijimtarisë popullore, të shkrimtarëve më në zë u anashkaluan në gjuhën standarde. Nga përvoja në Francë, lypet të kemi edhe një qasje pozitive. Kështu, Franca ka botuar fjalorin e frankofonisë (Le Vocabulaire de la Francophonie) i një lloji të paparë. Ky fjalor përmban fjalë të gjuhës franceze që nuk janë në fjalorët e Akademisë Franceze, madje nuk përdoren fare as në Francë, Belgjikë, Zvicër, Kanada ku frëngjishtja është gjuha mëmë. Këto fjalë u mblodhën në ish-kolonitë me ngjyrë të Francës: në Madagaskar, në Afrikën Qendrore etj., për ta pasuruar gjuhën e vet që nuk është dëgjuar as folur në Francë. Pra, kemi të bëjmë me një platformë dhe filozofi gjithëpërfshirëse. Kjo filozofi duhet të na drejtojë edhe ne.

E metë tjetër që pësjtjellon e nuk i qartëson shqipfolësit e huaj është mosparaqitja ortografike përmes shenjave diakritike e tingujve me dy bashkëtingëllore. Propozimi nga Mjeda dhe një grup studiuesish në Kongresin e Manastirit, që s’u miratua, duhet të rikonsiderohet. Kështu, një i huaj fjalën mes-hollë rrezikon ta lexojë së bashku e t’i japë një kuptim tjetër përmbajtësor -meshollë-, ose emrin - Et hem, mund ta lexojë Ethem që e ngatërrojnë pa vetëdije. Fenomeni tjetër për pasurimin e gjuhës është përmes shtimit të leksikut nga lart, nga profesionistët, akademikët e gjuhësisë si dhe burimi i fjalës së traditës së popullit së bashku me neologjizmat bashkëkohorë të nanoteknologjisë në epokën e globalizmit.

³⁵ Astrit Memia, “Njeriu dhe natyra në globalizëm”, Botim FIM, 2010, f. 162.

Rilindasit ishin të parët që morën këtë nismë për të shqiptuar edhe fjalët ndërkombëtare, ndërkombëtarizmat. Në shqiptimin përkthyes të kalkeve gjuhësore patën suksese (p.sh. adverbe - ndajfolje), ndërsa në shqiptimin e ndërkombëtarizmave nuk u arrit ajo që pritej (p.sh. gjithëmësonjëtoje - universitet). Me fjalën e leksikon ndodh si me ligjin për analogji. Kur një ligj miratohet në parlament dhe nuk është i zbatueshëm për shoqërinë e komunitetin është i destinuar të ndryshojë, sepse quhet ligj i dështuar dhe i pazbatueshëm, kjo që në lashtësi... Kështu ndodh edhe me gjuhën, nëse një fjalë ofrohet nga gjuhëtarët për folësit e një gjuhe dhe nuk asimilohet në përdorimin e përditshëm, është e destinuar të dështojë dhe mos të rrokët e të përdoret nga folësit e gjuhës në të gjitha stilet e nivelet e saj. Kështu kemi përpjekjen për të zëvendësuar fjalët: - iniciativë me nismë, biçikletë me dyrrotësh etj.

E para tashmë ka gjetur terren në mbarë gjuhën shqipe dhe është pranuar nga të gjithë dhe përdoret me shumë ëndje në të folurën familjare, popullore, masmediatike e administrativo-juridike, pra mund të themi me plot gojën se i përket standardit në të folur e të shkruar. Krejt ndryshe ndodhi me fjalën tjetër “dyrrotësh”, që nuk u përqaftua nga folësi dhe përsëri mbeti në standard përdorimi i fjalës biçikletë, kështu dështoi edhe fjala futboll për t’u zëvendësuar me topkëmbë. Pra, jo çdo ndërkombëtarizëm mund e duhet të shqipërohet e përkthehet, sepse po nuk e pranoi folësi, përdoruesi i përditshëm, nuk mund të zërë vend në standard. E kundërta ndodh me fjalën burimore shqipe apo latino-ilire dhe latino-dardane...

Kështu fjalët me burim geg, kryesisht të përdorura në dialektin dardanisht (kosovarisht): bujtinë, barnatore, ëmbëltoje kanë zëvendësuar fjalët e huaja: konvikt, farmaci, pastiçeri dhe janë bërë pjesë e standardit, pavarësisht cave që ua gërvishte veshin në vitet 1990, kur filluan të përdreshin për herë të parë në Tiranë. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1980, dy fjalë mjaft të përdorura nga popullata rurale, misër³⁶ dhe gështenj³⁷, nuk kanë sinonime dhe as nuancat e holla të përafërta kuptimore.

Gjatë një interviste që kam zhvilluar me kryetarin e Akademisë së Shkencave, akademikun Shaban Demiraj³⁸, pas pyetjeve të para për mbarëvajtjen e ASH-së, i parashtrova në interaktivitet çka më sipër për vizionin e tij, për të ardhmen e shqipes standarde. Akademiku Sh. Demiraj me një zâ të trashë e kumbues, duke i ndarë fjalët me pauza nga njëra- tjetra, me shumë mirëkuptim, m’u drejtua: “Po, jam plotësisht në dakordësi me çka ju parashtruat, por këtë që kemi arritur ta prishim?!” Ishte përgjigje me pyetje retorike.

“Jo, Profesor, mos ta prishim çfarë është arrit, por ta pasurojmë shqipen drejt plotënisë së saj me gegnishten, arbërishten e prurjet nga mbarë mërgata”, - ia ktheva unë. “Po, - ma ktheu akademikun, - jam shumë në dakord e s’duhet t’i ndalojë askush shkrimtarët, poetët e studiuesit të shkruajnë e të shprehen në gegënisht dhe më të arrirat të mirëseleksionohen nga profesionistët e studiuesit gjuhësor për t’u bërë pjesë e standardit në të gjitha sistemet e zhvillimeve në bazë të ligjshmërisë së brendshme të gjuhës shqipe”.

³⁶ *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, 1980, f. 1147.

*Kështu misër; në dardanisht përdoret edhe kollomoq, drith, galinxh (përdoret si emër për misrin e paplotë që fshatarët ushqejnë bagëtitë dhe s’e përdorin për vete), galanxh (për misrin që ka ca fara të zeza në boç), shtalbak (që nënkupton misrin e papjekur, misër i njomë, përdoret edhe si metaforë ironizuese ndaj ndonjërit që flet kuturu: “je shtalbak akoma (i papjekun), të qet buza tamel”). Kështu edhe gështenja ka emërtime për çdo ndryshim të formës së saj si frut. Thuhet -pikçe- dhe nënkuptohet gështenjë e rënë nga eshka e hapur në rrem, pra pik në tokë vetë, një gjysmë onomatopeje...Thuhet rrokçe (ha gështenjë rrokçe) kuptohet e pazier, e papjekur, për t’u ngrënë direkt me dhëmbë e fort pasi t’ia heqësh lëkurën. Edhe kjo një gjysmë onomatopeje (kërcitja e dhëmbëve me gështenjën e fort krijon kërcitje - rrrroookkk(shsh)ç...). Thuhet porogaç dhe kuptohet gështenjë e pjekur në prush dhe e qëruar nga lëvozhga e djegur (si etimologji popullore: porogaç - poro-gac).

³⁷ *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, 1980, f. 552.

³⁸ Radio Tirana, “Emisioni për Bashkatdhetarët” (viti 1996), intervistë nga Astrit Memia.

Sigurisht, kjo intervistë-bisedë dhe intervista që ne ekipi realizues i TV ATN bëmë para se të shkonte në botën e pasosme me shqipëruetin dhe intelektualin e pazëvendësueshëm Gjon Shllaku (njohës i 18 gjuhëve të huaja e kryesisht i gjuhëve të vdekura) më motivuan që t'u përkushtohesha edhe më shumë studimeve gjuhësore dhe albanologjike. Për reformimin ka shprehur opinionin edhe akademiku Rexhep Ismaili³⁹, i cili ndër të tjera thekson: “Standardi i sotëm i shqipes nuk mund t'u imponohet shqiptarëve që jetojnë në Kosovë, Maqedoni apo treva të tjera shqiptare” dhe: “Duhet të kemi një shqipe që të gjithëve t'u bjerë si këmisha e trupit, të mos jetë as e ngushtë, as e gjerë”.

Edhe shkrimtari Kadare mbështet nevojën e pasurimit të gjuhës standarde dhe thotë se gjuha letrare për fat të keq përzihet me standardin gjuhësor dhe se gjuha është një kontratë shoqërore. Ndër të tjera ai thekson: “Ka 120 vjet⁴⁰ që shqipja pak a shumë shkruhet sipas standardit. Por njëkohësisht ka pasuri të mëdha që kanë ngelur jashtë. Sot, fatkeqësisht fjalorët e gjuhës shqipe janë tërë mungesa”. Njëkohësisht ai shprehet që çdo shkrimtar ka të drejtë të përdorë gjuhën, dialektin, madje nëndialektin që dëshiron, kjo hyn në lirinë e krijimit dhe askush nuk mund t'i ndërhyjë. Sociolekti i Tiranës, i Prishtinës e i Shkupit po ndërthurin të gjitha format e dialekteve të shqipes në një qendër urbane.

Lypset të tejkalohen qëndrimet e ngurta të studiuesve që mbrojnë tezën e paprekshmërisë së kodit standard. Edhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe ka porositur që “duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr politika gjuhësore, rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura”. Ajo që në gjuhë është e përhershme janë ndryshimet - pohon linguisti Egon Fekete. Edhe gjuhëtari M. Çeliku shprehet që të presim që mjetet ekzistuese të bëhen më të përdorshme dhe të futen në përdorimet themelore të paskajores dhe të bëhet paskajore e natyrshme e shqipes standarde.

Këtë ide e mbështet edhe gjuhëtari Rrahman Paçarizi, i cili shprehet që nëpërmjet një politike më liberale gjuhësore të lejohet futja si alternativë e paskajores gege dhe e pjesores së shkurtuar. Një tjetër gjuhëtar, A. Klosi, shprehej për “demokracinë në gjuhësi” duke rishikuar dhe përmirësuar standardin. Edhe gjuhëtarja L. Shamku shprehet se të metat e kodit nuk duhen konsideruar si kundërgjegjësi kundër kodit. Duke e ditur se çështjet e standardit gjuhësor janë çështje të rendit filologjik, përparësi marrin folësit, ata që prodhojnë gjuhë dhe njëkohësisht gjuhëtarët me fleksibilitetin e tyre janë ata që mund të kodifikojnë standardin jashtë qëndrimeve emotive, subjektive dhe emocionale. Këtu nuk ka vend keqinterpretimi i Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, ku kosovarët unifikuan gjuhën shqipe me moton “Një komb, një gjuhë” sepse ajo kërcënohej nga gjuhët sllave dhe rrezikohej identiteti kombëtar i Dardanisë antike.

Një Kongres* i ri kodifikues i standardizimit mbështetur në rrafshin diakronik e sinkronik, me studiues e shkencëtarë nga mbarë trevat e hapsirës jetike shqiptare dhe mërgata kudo në botë, si dhe nga gjuhëtarë e albanologë të huaj lypset të mirëkuptohet nga të gjitha palët, si gjithpërfshirje dhe jo përjashtim. Ide e mbështetur edhe nga akademiku B. Beci⁴¹.

³⁹ Qemal Murati, “Për shqipen standarde”, Prishtinë, 2009, f. 37.

⁴⁰ Qemal Murati, “Për shqipen standarde”, Prishtinë, 2009, f. 47-48.

* Në një sondazh të organizuar nga Forumi “Imazh & Media - Imazhi Shqiptar & Identiteti Kombëtar”, në muajin mars të vitit 2022, në kryeqendrat e shqiptarëve në Ballkanin Ilirik (Tiranë, Prishtinë, Shkup, Ulqin, Janinë, Preshevë), si dhe në mërgatë (Itali, Francë, Gjermani, SHBA, Kanada, Zvicër, Angli), nga 873 të intervistuar (përmes telefonit, takimeve direkte dhe plotësimit të formularëve), në grupmosha e profesione të ndryshme rezultoi se: a. Pyetjes: A e mbështesni pasurimin e gjuhës shqipe (standardin) si domosdoshmëri, iu përgjigjën 97% me po, 3% abstenuan. b. Pyetjes: A e mbështesni reformimin evolutiv, “të butë” të standardit, 83% iu përgjigjën me po, 7% me jo dhe 20% abstenuan. c. Pyetjes se a janë për ndryshim të pjesshëm apo thelbësor të standardit të vitit 1972, 67% iu përgjigjën me po, për ndryshim të pjesshëm, 31% ishin për ndryshim thelbësor dhe 2% abstenuan (P.s.: Çdo i intervistuar kishte të drejtë të plotësonte me përgjigje të tria pyetjet sipas dëshirës).

⁴¹ Radio Tirana “Emisioni për bashkatdhetarët”, intervistë nga Astrit Memia, Paris, mars 1998.

Edhe akademiku I. Ajeti⁴² është shprehur për një krizë që ekziston në historinë e gjuhësisë shqiptare dhe në shkencat albanologjike, mbasi konstaton se brezi i vjetër i gjuhëtarëve të vjetër nuk rron më. Ai shpreh shqetësim për nivelin e pakënaqshëm të kulturës gjuhësore, sidomos në media dhe në përdorimet publike; gabime drejtshkrimore, luhatje të theksuara në shqiptimin letrar, përdorime formash gramatikore jonormative, ndërtime jo të rregullta të fjalëve, përdorim i tepruar i fjalëve të huaja të panevojshme dhe ndikime të huaja në ndërtimin e fjalisë që dhunojnë strukturën sintaksore dhe veçantinë kombëtare të saj.

Edhe akademiku Rexhep Qosja ngre të njëjtin shqetësim duke u shprehur: “Jemi turrur të hyjmë në Europë duke përdorur sa më shumë fjalë europiane, por duke harruar se në Europë nuk hyhet duke humbur identitetin gjuhësor dhe kombëtar”. Qosja për pastërtinë e gjuhës shqipe ndjek parimin e rilindasve, të përdorimit të gjuhës shqipe në vend të fjalës së huaj. Shpesh ka përdorur fjalë “të harruara” (për personat përdor vetjet si dikur F. Konica). Ai e vlerëson gjuhën si biografia e popujve sepse me gjuhën më mirë se çdo dokument material, ruhet historia e tyre intelektuale, si dhe vlerëson krijimin e një fjale të re, jo si një punë e vogël, por sikur të krijosh një vepër artistike a shkencore.

Fjalën e quan njëkohësisht edhe varg, strofë, vjershë, fjalë e urtë, cashë e lashë, gjë e gjëzë, rrëfim i shkurtër, tregim i gjatë, kapitull romani, skenë a pamje drame, të ndodhur para pesëqind vjetësh a pesë ditësh, kurse të gjitha fjalët e një fjalori, së bashku, roman i madh dhe fjalorët kanë vlera shumëdimensionale. Gjuha si mjet komunikimi për të shprehur një ide a një mendim të caktuar nuk mjafton vetëm një rend logjik që të ketë kuptim, por duhet ta shprehim me rregullsi gjuhësore, drejtshkrim korrekt me gramatikë të drejtë dhe me shprehje të bukur duke pas në vëmendje anën stilistikore dhe estetike.

Dallohen disa stile: stili i letërsisë artistike, stili tekniko-shkencor, stili politiko-shoqëror, stili administrativ. Stilistika gjuhësore merret me studimin e stileve të gjuhës letrare. Sot, gjuha shqipe është lëndë me zgjedhje në dhjetëra universitete të botës ku funksionojnë edhe katedrat e gjuhës shqipe, së fundmi që nga Universiteti i Harvardit në SHBA, në universitetet e Europës, Rusi e deri në Kinë. Kjo kërkon pasurimin dhe ngritjen në plotinë e saj të standardizimit të shqipes.

4. Përfundime

➤ Elaburimi i rihapjes, i riorganizimit të një kuvendi në nivel ndërkombëtar për ngritjen në majat më të arrira bashkëkohore të gjuhës shqipe është i arsyeshëm dhe real. Realizimin e kësaj e imponojnë sot qytetërimi dhe modernizimi europian. S’duhet të jemi skeptikë, s’bën të hamendemi as të qëndrojmë indiferentë, neglizhentë apo defetistë.

➤ Gjuha shqipe, si kryesimboli kombëtar e si tempulli i të shprehurit të diturisë, nuk është privilegj, por obligim i inteligjencës dhe i brezave. Gjuha shqipe nuk i takon asnjë partie, shoqate, intelektual apo individ, ajo është hyjnore dhe natyrale. Gjuha shqipe në kuptimin utilitar të fjalës i shërben njeriut dhe shoqërisë drejt majave më të larta të shkencës, teknikës, për të arritur lirinë e plotë të shpirtit e të mendjes. Shqipëria dhe Kombi Shqiptar, vendosja gjeostrategjike e saj në Europën e qytetëruar e moderne imponon emancipim dhe profesionalizëm elitare, që t’u përgjigjen zhvillimeve moderne të shkencës dhe teknikës bashkëkohore. Lypset të prezantohemi si një komb me tradita të lashta kulturore dhe civilizim, human, liberal e demokrat në Europën Juglindore dhe në Europë, kjo arrihet pikë masparit përmes mirëpërdorimit të gjuhës sonë amtare, pa komplekse inferioriteti krahasuar me gjuhët e tjera të vetëquajtura “të mëdha” dhe elitare.

⁴² “TV ATN 1”, intervistë nga A. Memia, Prishtinë, qershor 1999.

➤ Gjuha shqipe e rimirëformatuar standarde do të marrë vendin meritore si instituti i gjithë diturisë dhe do t'i shërbejë qytetërimit të brezave, arsimit, shkencës, kulturës, pasurimit, ekonomisë së tregut.

➤ Gjuha shqipe natyrore dhe bashkëkohore e mirëpërdorur, mbështetur në rrafshin diakronik e sikronik, do të ngrejë jetën duke i dhënë kuptim të plotë, vlerë dhe dinjitet njerëzor.

➤ Psikika etnokulturore shqiptare dhe veshja e mendimit përmes gjuhës është çelësi i lirisë dhe i demokracisë së qytetërimit tonë mbarëkombëtar, brendashqiptar e në mërgatë.

➤ Realiteti imponon sot hapjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe duke mos përfillur tabutë (tembez par terr) e mospasurimit të gjuhës standarde si një aksiomë e dhënë njëherë e përgjithmonë.

➤ Zhvillimet aktuale pas 3 dekadash tranzicion kërkojnë guxim, vendosmëri, përgjegjësi për të sotmen e të nesërmen e dijes, shkencës, gjuhës, albanologjisë, etnokulturës, diplomacisë kulturore, publike e qytetare, për ngritjen intelektuale të brezave në Shqipërinë etnike. Kushtet e reja demokratike që u krijuan në Europë imponojnë përparimin, arsimimin, emancipimin për të jetuar si qytetarë të mirëfilltë europianë, në multietnicitet, në diversitet kulturor e gjuhësor. Gjuha shqipe, si kryevlerë e kohës, do të jetë një urë afrimi me Perëndimin dhe do t'i shërbejë progresit e prosperitetit, në rajon dhe më gjerë.

➤ Çështja e rivitalizimit e ruajtjes dhe domosdoshmëria e pasurimit të gjuhës shqipe duhet të kuptohet nga politikanët, qeveritarët dhe intelektualët shqiptarë si nevojë e kohës dhe oksigjen për brezat e rinj. Gjuha shqipe krahas gjuhëve të tjera do të rrisë konkurrencën profesionale, do të ngrejë në një nivel më të lartë pasurinë intelektuale të mendimit elitare shqiptar, si pasurinë më të çmuar kombëtare, si dhe do të përgatisë ekspertë, specialistë, teknikienë, politologë, diplomatë të të gjitha fushave që dinë t'u shërbejnë brezave në shkollat pasuniversitare dhe universitare. Gjuha shqipe në përsosmërinë e saj do të përballet në nivelet më të larta e të arrira me gjuhët e ashtuquajtura të mëdha të Europës drejt shtigjeve të përparimit dhe civilizimit. Pikërisht, edhe ky konkurrim i padukshëm me botën e civilizuar perëndimore e bën edhe më të domosdoshëm këtë fenomen të një riorganizimi ndërkombëtar të shqipes, mbështetur në kritere profesionale e shkencore, që kombi ynë të paraqitet si fisnik e partner modern, partner i denjë, mes civilizimeve perëndimore.

➤ Gjuha shqipe, si institut i gjithë diturisë kombëtare shqiptare, ka rëndësi qenësore jetike për përparimin, lumturinë dhe ardhmërinë e sigurt të bijve dhe bijave të tij. Është kërkesë e kohës që brezi i ri të arsimohet në vendin e vet me sa më pak shpenzime e me mbikëqyrjen e prindërve dhe të shoqërisë. Koha e kërkon që gjuha shqipe e mirëstandardizuar në plotësinë e saj t'i shërbejë kombit shqiptar për t'u integruar në institucionet euroatlantike dhe civilizimet perëndimore.

➤ Njohja mirë e gjuhës shqipe do t'i shërbejë shkollimit dhe mësimin me lehtësi të gjuhëve të huaja nga brezi i ri dhe do t'i motivonte intelektualët shqiptarë që të ndërprisnin largimin nga trojet etnike shqiptare mijëra vjeçare pellazgo-iliro-dardano-arbnoro-shqiptare. Kështu që, gjuha shqipe e gjallë do të ngrihet në nivelet bashkëkohore të simotrave të tyre perëndimore, duke synuar drejt ndërkombëtarizimit të saj, pse jo, si lëndë me zgjedhje në universitetet e shteteve euroatlantike e më gjerë... **Gjuha shqipe, si gjuhë natyrale e gjallë, lypset të konsiderohet, thirret e quhet nga studiuesit, shkencëtarët, poetët e shkrimtarët, dijetarët e besimtarët gjuhë e dritës universale për albanologjinë, si dhe që do të ndriçojë rrënjët në studimet e hulumtimet e gjuhëve të vdekura në botë.**

Referencat

- [1]. Eqrem Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, 2009.
- [2]. Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, 1994. Eqrem Çabej e veprat themelore të tij: “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, në shtatë vëllime, I “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”, II “Fonetikë historike” (1958), “Meshari i Gjon Buzukut” (1968), “Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes” (1944).
- [3]. Shaban Demiraj: Eqrem Çabej, 1990.
- [4]. Faik Konica: *Vepra*, 1993.
- [5]. Selami Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i Vitit 1485*, botim, 1974.
- [6]. Ismajli, R., “*Rreth shqipes standarde, kodeve të tjera dhe kontestimeve*”, Studime Filologjike, 1-2, Tiranë.
- [7]. Ismajli, R., *Standarde dhe identitete*, Dukagjini, Pejë.
- [8]. Ismajli, R., “*Politika (e munguar) e gjuhës*”, në *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, QSA, Tiranë.
- [9]. Mehmet Elezi, “*Heshjtje Varri për një djep të shenjt*” (publicistikë). “*Gjuha shqipe me një mushkëri*”.
- [10]. Mehmet Elezi, *Drejtshkrimi i Gëgnishtes ose Gëgnishtja e Standartizuar*.
- [11]. Çabej, Eqrem (1980). *Hyrje në gjuhësinë krahasimtare-historike*. Prishtinë.
- [12]. Çabej, Eqrem (1987). *Studime gjuhësore III. Rilindja*: Prishtinë.
- [13]. Demiraj, Shaban (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Rilindja: Prishtinë.
- [14]. Demiraj, Shaban (1989). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Rilindja: Prishtinë.
- [15]. “*Ese për gjuhët natyrale dhe gjuhët artificiale*”, Faik Konica (2019).
- [16]. Ismajli, Rexhep (1987). *Artikuj mbi gjuhën shqipe*. Rilindja: Prishtinë.
- [17]. *History of the English Language* - English Club. Historia e gjuhës frënge dhe Statistikat e OIF.
- [18]. Topalli, Kolec (1995a). *Theksi në gjuhën shqipe*. Shtëpia Botuese Enciklopedike: Tiranë.
- [19]. Sh. N. Joklin, Albanich 120. - *Te Leibnici dhe krahasime etimologjike interesante për disa fjalë të shqipes*.
- [20]. Topalli, Kolec (2012). *Shtresimi i huazimeve nga gjuhët ballkanike në një fjalor etimologjik*.
- [21]. *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë (175-183).
- [22]. Jakov Milaj: “*Raca Shqiptare*”, *Studim Antropologjik e Historik*, (Ismail Mal Osmani, Botonjës - Tiranë, 1944).
- [23]. “*Diplomacia shqiptare*”, vëllimi I, II, III, L. Bashkurti.
- [24]. Daniel Xhoxhaj: *Hyrje në leksikografi* - Makrostruktura e mikrostruktura e fjalorëve shpjegues shqip e frëngjisht (2000).
- [25]. Rrokaj Shezai, “*Filozofi e gjuhës*”.
- [26]. Gjovalin Shkurtaç, “*Ligjërimet arbëreshe*”.
- [27]. Bahri Beci: “*Gramatika e gjuhës shqipe*” (2005), “*Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*” (Shkodër 2000, Prishtinë 2001), “*Gramatika e gjuhës shqipe*” (Tiranë 1997, Prishtinë 1998 dhe 2002).
- [28]. “*Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës*” (1995)
- [29]. Memushaj, R., *Për shqipen standarde I - Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*, Infbotues, Tiranë, 2012.
- [30]. Ismajli, R., “*Në gjuhë “ dhe “për gjuhë*”, Dukagjini, Pejë.
- [31]. Hoxhaj, B., *Lëvizjet semantike të parafjalëve në gjuhën shqipe*, Jupiter Group, Tiranë, 2022.
- [32]. Riza, S., *Pesë autorët më të vjetër në Gjuhën Shqipe*” (Buzuku, Matrënga, Bardhi, Budi dhe Bogdani), 2003.
- [33]. Riza, S., “*Vepra 1*”, më 1996, “*VEPRA 3*”, më 2003 dhe “*VEPRA 4*” më 2004.
- [34]. Haris Silaixhiç, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*.
- [35]. Kristo Dako, “*Korrespondenca me Charles Crane*”, “*Kush janë Shqiptarët*”.
- [36]. Astrit Memia, “*Njeriu dhe Natyra në Globalizëm*”, 2010, FIM.
- [37]. Astrit Memia, “*Mikpritja Shqiptare dhe Epoka e Globalizmit*”. Botimi, Tiranë 2018.
- [38]. Revista “*Global Challenge*” (ISSN) ADSH. – Revista “*Philosophica*” (ISSN) UT. – Revista “*Diplomacia*”, ADSH.
- [39]. Revista “*Albania Image*”, FIM. – Revista “*Imazhi Shqiptar*”, FMISHIK.
- [40]. Petro Zheji, *Studimet Gjuhësore: 1. Shqipja dhe Sanskritishtja – dy vëllime 2. Libri i aforizmave 3. Roli mesianik i gjuhës shqipe*.